

Mars 2007

Zbulimi në Kosovë
Vështrimi përpara

Jérôme Mellon



VENDI SIGURTË
BEZBEDNOMESTO
SAFE PLACE





Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) është një organizatë joqeveritare kosovare që promovon përfshirjen e qytetarëve të Kosovës në proceset shoqërore dhe ato të vendim-marrjes përmes programeve të ideuara që përqëndrojnë vëmendjen në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.



Saferworld është një organizatë e pavarur joqeveritare që punon me qeveritë dhe shoqërinë civile në planin ndërkombëtar për të hulumtuar, promovuar dhe zbatuar strategji të reja për të rritur sigurinë e njerëzve dhe për të parandaluar dhunën e armatosur

Zbulimi në Kosovë

Vështrimi përpara

Mirënjohje

Ky raport është shkruar nga Jérôme Mellon i udhëzuar nga ekipi i projektit VendiSigurtë në Forumin e Iniciativës Qytetare dhe Saferworld-it. Të dy këto organizata u falenderohen këtyre individëve, qoftë analistë të pavarur ose nëpunës të Qeverisë së Kosovës ose të administratës ndërkombëtare në Kosovë, për kontributin e tyre të çmuar në këtë raport. Ne, poashtu dëshirojmë të falenderojmë Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar dhe atë të Gjermanisë për financimin e këtij publikimi përmes mbështetjes së tyre për projektin VendiSigurtë.

Përmbajtja

Parathënie	5
Konteksti i veçantë i Kosovës	6
Tabloja aktuale në fushën e zbulimit	7
Të kuptuarit se çfarë do të thotë zbulimi sot	8
Praktikat më të mira për zhvillimin ose reformimin	10
e shërbimeve informative	
Krijimi i një shërbimi informativ për Kosovën	12
Mandati dhe detyrat	12
Plotësimi me personel	13
Mbikëqyrja parlamentare	14
Pavarësia dhe paanshmëria	15
Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet me organizatat e tjera të Kosovës	15
Ndërlidhja me organizatat e huaja	16
Zhvillimi i qëndrueshëm	17
Sendërtimi i llogaridhënies publike	17
Përfundim	19
Për lexim të mëtejshëm	20

Parathënie

I hartuar në kuadër të kornizës së projektit VendiSigurtë, në këtë raport analizohen disa nga praktikat më të mira të zhvilluara ndërkombëtarisht në lëmin e reformës dhe të zhvillimit të shërbimit të zbulimit dhe shqyrtohet mënyra sesi ato duhet të aplikohen në Kosovë. Çështja se a të themelohet një kapacitet për një shërbim zyrtar të zbulimit për Qeverinë e Kosovës ka dalë në sipërfaqe herë pas here viteve të fundit. Çfarë është më me rëndësi, në shkurt të vitit 2007, Propozimi i qartë i Emisarit Special për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Martti Ahtisaari, rekomandon që Kosova të themeloj, "...një agjenci vendore të sigurimit për monitorimin e kërcënimeve të paraqitura ndaj sigurisë së brendshme të Kosovës", e cila duhet të jetë, "...profesionale, apolitike, shumetnike dhe e cila i duhet nënshtruar mbikëqyrjes parlamentare dhe administrimit civil." Ky publikim ka për synim hapjen e një diskutimi të shëndoshë publik për këtë çështje, si dhe të bëjë rekomandime konkrete për themelimin dhe rritjen e një shërbimi të tillë.

Tetë çështjet kryesore që kanë të bëjnë me themelimin e një shërbimi informativ në Kosovë janë marrë në konsideratë në këtë raport: mandati dhe detyrat, plotësimi me personel, mbikëqyrja, pavarësia dhe paanshmëria, bashkëpunimi me organizatat e tjera në Kosovë, ndërlidhja me partnerë të huaj, zhvillimi i qëndrueshëm dhe llogaridhënia publike. Në secilën prej këtyre lëmive, ky raport jep rekomandime konkrete dhe vepruese që janë në vijë me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe me parimet demokratike. Derisa pranohet se problemet e tilla siç janë: kapaciteti i ulët institucional, politikat trazuese dhe luftërat e fraksioneve paraqesin vështirësi reale për realizimin e këtyre praktikave më të mira dhe parimeve, ne besojmë se ky raport ofron pikat standarde kundrejt të cilave, mund dhe duhet të gjykohet progresi në drejtim të tyre.

Ky raport është paramenduar si kontribut për debatin lidhur me themelimin e shërbimit informativ në Kosovë që vërtet ende nuk ka filluar, dhe si i tillë do t'i informojë avokimin dhe median për punën e kryer në kuadër të projektit VendiSigurtë. Deri më tani, raportet e herë pas hershme në media përkitazi me këto çështje, që shpesh janë përqendruar në veprimet e grupeve të parregulluara që veprojnë joformalisht në këtë fushë në Kosovë, kanë qenë burimet kryesore të informatave. Pothuajse asnjë diskutim informues nuk është mbajtur, dhe analiza e nxituar e ndërmarrë nga Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme (RSSB) i porositur nga KB-ja është kontributi i vetëm real në fushën e politikave.

Me anë të avokimit për një shërbim të vazhdueshëm informativ për Kosovën, të paanshëm, apolitik, të përgjegjshëm, efikas dhe të qëndrueshëm, ky raport i paraqet publikut kosovar dhe shoqërisë civile një imazh bashkëkohor se çfarë duhet të jetë një shërbim informativ, duke synuar ta demistifikojë rolin dhe mandatin e një shërbimi informativ të vendit. Tani nevojitet një debat parimor dhe pragmatik mbi atë nëse një shërbim në fakt mund të krijohet dhe se si duhen trajtuar çështjet si mandati, rekrutimi dhe mbikëqyrja e këtij shërbimi. Parlamentarët, shoqëria civile dhe publiku i gjerë, që të gjithë duhen marrë pjesë aktive në atë debat. Pa një debat të tillë, ka pak shpresa se kosovarët do të përqafojnë konceptet bashkëkohore të sigurisë dhe zbulimit dhe se do të mbështeten përpjekjet për të siguruar funksionimin e rregullt të një shërbimi të ri në përputhje me normat demokratike.

Jérôme Mellon
Mars 2007

Konteksti i veçantë i Kosovës

Në fund të viteve të 1990-ta, luftëtarët etnikë shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nisën luftën guerile kundër forcave jugosllave të stacionuara në Kosovë. Kur Presidenti jugosllav Slobodan Millosheviq urdhëroi shtypjen e dhunshme kundër luftëtarëve dhe civilëve shqiptarë, bashkësia ndërkombëtare reagoi dhe në mars të vitit 1999, filloi një operacion ushtarak i udhëhequr nga Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). Pas një fushate 78-ditore, forcat jugosllave u tërhoqën nga Kosova dhe më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (KB) miratoi Rezolutën 1244. Që atëherë, krahina autonome e Kosovës administrohet nga KB-të, pavarësisht se ende, sipas së drejtës ndërkombëtare është pjesë përbërëse e Serbisë.

Sipas këtij aranzhimi të papërsëritshëm, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve (PSSP) mban autoritetin përfundimtar ekzekutiv mbi administrimin e krahinës përmes Misionit të Përkohshëm të KB-ve në Kosovë (UNMIK). Që nga viti 1999, një qeveri vendore, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), është zhvilluar dhe kompetencat gradualisht janë bartur në ministritë dhe institucionet e saj të llojllojshme. E udhëhequr nga Kryeministri dhe Presidenti, dhe e përbërë nga një asamble parlamentare - Kuvendi i Kosovës dhe pesëmbëdhjetë ministri, IPVQ-të tani kanë hyrë në negociata me homologët e tyre nga Serbia për të definuar statusin juridik të krahinës. Këto bisedime mbi statusin e ardhshëm kanë filluar me 20 Shkurt 2006 dhe u ndërmjetësuan nga Emisari Special i KB-ve Martti

Ahtisaari, i cili paraqiti Propozimin e tij të Qartë mbi Zgjidhjen e Statusit të Kosovës tek Qeveritë e Beogradit dhe Prishtinës me 2 shkurt, 2007. Ky propozim pastaj do të konsiderohet nga Këshilli i Sigurimit të KB-ve para hartimit të paraparë të një rezolute re mbi Kosovën.

Pavarësisht nga mundësia e përfundimit të gjendjes së një pritjeje politike në të cilën Kosova ka mbetur për më shumë se shtatë vite, pesimizmi dhe frustrimi i përhapur në mesin e popullatës është rritur përballë rritjes së ulët ekonomike, papunësisë dhe jostabilitetit të lartë politik. Përveç nxitjes së padurimit dhe frustrimit të popullatës vendore, shpesh sistemi i paqëndrueshëm i sigurisë, gjendja e rëndë e infrastrukturës së Kosovës, niveli i lartë i ndotjes dhe prodhimi i pasigurt si dhe furnizimi me energji elektrike e bëjnë Kosovën një propozim aspak joshës për shumicën e investitorëve të huaj.

Në këtë kontekst, sektori i sigurisë në Kosovë ka evoluar, tani me një Shërbim Policor të Kosovës (SHPK) me një forcë prej 7,000 në bërthamën e vet, por poashtu e përbërë nga institucionet siç janë: Zyra për Siguri Publike (ZSP) e IPVQ-ve dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), një shërbim civil emergjent.¹ Shumë aspekte të sigurisë në Kosovë ende janë kompetencë e Forcave të Kosovës (KFOR) të NATO-s dhe të Policisë Civile të UNMIK-ut (CivPol), por kohëve të fundit, me themelimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, pritet që të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e brendshme në fund të transferohen nga UNMIK-u te IPVQ-të.

¹ Propozimi i Qartë për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës rekomandon që TMK-ja të shpërbëhet, "... brenda një viti pasi që kjo Zgjidhje të hyjë në fuqi." Megjithatë ky raport konsideron TMK-në si një partner të rëndësishëm dhe aktiv të FSK-së së ardhshme, edhe pse ky partneritet mund të tregohet si jetëshkurtër.

Tabloja aktuale në fushën e zbulimit

Tani për tani, në kuadër të IPVQ-ve nuk ka shërbim informativ. Megjithatë, UNMIK-u dhe KFOR-i kanë një rol të kufizuar në vend sa u përket çështjeve të zbulimit, pasi që të dy i analizojnë informatat për të vlerësuar se cilat janë kërcënimet e mundshme për popullin dhe stafin ndër-kombëtar - kërcënime si fatkeqësitë natyrore, demonstrata të dhunshme dhe sëmundje shpërndarëse. Përveç tjerash, SHPK-ja, e cila ende është njësi në kuadër të strukturës së Policisë Civile të UNMIK-ut në pritje të transferit të saj në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka një funksion në zbulimin e veprave penale, që është marrë përsipër nga Drejtoria e SHPK-së për Analizimin e Krimeve.

Disa organizata, siç është Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinioneve Publik (IHSOP) dhe Shërbimi Informativ i Kosovës (SHIK), janë duke operuar në atë mënyrë që ka ngjashmëri me shërbimet informative. Mirëpo, pasi që ato veprojnë në atë mënyrë pa mandat legjislativ dhe pa kontroll dhe mbikëqyrje parlamentare, në fakt këto organizata janë ndërmarrje private dhe si rrjedhojë nuk mund të konsiderohen si shërbime informative legjitime zyrtare të IPVQ-ve. Historia e kohëve të fundit e sundimit autoritar e

ka lënë popullatën kosovare me përshtypjen se shërbimet informative për nga natyra janë mjet represioni ose instrument i shpërdorimit që kontrollohet nga grupet e vogla të interesit, nganjëherë të lidhura me partitë politike. Fatkeqësisht, ky keqkuptim është i zakonshëm në mesin e qytetarëve të Kosovës, duke përfshirë politikanët, gazetarët, dhe si rrjedhojë fjala zbulim është bërë një fjalë e 'ndyrë' dhe tabu. Debatet publike mbi çështjet e zbulimit janë të rralla, duke u munduar kështu që të theksohet niveli i pabarabartë i dijenisë dhe kuptimit të cilin Kosovarët e kanë për këto çështje.

Derisa ekziston nevoja e justifikueshme që disa çështje të mbeten jashtë domenit të publikut, shembujt e vendeve siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar demonstronë se si publiku, qeveria dhe komuniteti i zbulimit mund të përfitojnë nga një debat i sinqertë dhe i hapur përkitazi me rolin dhe mbikëqyrjen e çështjeve të zbulimit. Diskutimi i tillë publik dhe mbikëqyrja parlamentare janë shenja të një shoqërie demokratike të shëndoshë dhe të pjekur, prandaj si rrjedhojë duhet të promovohen dhe të mundësohen në dobi të të gjithëve.

Të kuptuarit se çfarë do të thotë zbulimi sot

Sot, zbulimi kuptohet si informatë që është përpunuar dhe analizuar për t'u ndihmuar vendim-marrësve. Ky koncept ka evoluar me kalimin e kohës, por gjithmonë e ka mbajtur të njëjtë objektivin e gjërë, e që është të sigurojë këshilla të parashikueshme me kohë, relevante, të sakta për njerëzit që marrin vendime.

Derisa zbulimi më shumë është lidhur me operacionet ushtarake dhe të sigurisë, sot ajo është një koncept i aplikuar në disa fusha, si për shembull në sektorin e biznesit. Megjithatë, zbulimi zakonisht kuptohet si një proces nëpërmes të cilit informacionet në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë mblidhen, përpunohen dhe analizohen para paraqitjes tek vendimmarrësit të cilët i përdorin këto për të marrë vendime mbi kërcënimet e mundshme me të cilat qeveria ose qytetarët e tyre mund të ballafaqohen, brenda dhe jashtë shtetit. Ky definicion përkitazi me kërcënimet ndaj sigurisë së shteteve dhe të qytetarëve është definicioni që është përdorur në këtë dokument.

Zakonisht grumbullimi, analizimi dhe përhapja e informatave të zbulimit janë detyra të shërbimeve informative. Shumica e qeverive në mbarë botën kanë themeluar shërbime të tilla, të cilat rëndom hyjnë në njërin nga katër kategoritë e mëposhtme:

- Shërbimet informative të vendit, poashtu të njohura si shërbimet e sigurisë, sigurojnë informata zbulimi që janë relevante si për sigurinë e brendshme të një vendi, ashtu edhe për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike. Ato zakonisht ngarkohen me grumbullimin e informatave lidhur me ata që mund të kërcënojnë sigurinë e shtetit përmes spiunazhit, sabotimit, dhunës politike, terrorizmit ose aktiviteteve të fshehta të drejtuara nga qeveritë e vendeve të huaja.
- Shërbimet informative të huaja sigurojnë informata zbulimi që janë relevante për sigurinë e jashtme të një vendi dhe bëjnë parashi-

kimin e kërcënimeve që vijnë nga jashtë. Për shembull, një raport i informatave të shërbimit të huaj të zbulimit do të mund të këshillonte qeverinë mbi gjasat që njëra nga ambasadat e saj jashtë vendit do të sulmohet nga terroristët, ose mbi përfitimet që lidhen me një marrëveshje të caktuar tregtare.

- Shërbimet informative kriminale sigurojnë informata zbulimi që janë relevante për veprimtari kriminale (p.sh. grupet e organizuara kriminale) dhe korrupsionin, të cilat përdoren për t'u asistuar agjencive të zbatimit të ligjit.
- Shërbimet informative ushtarake sigurojnë asistencë sa i përket planifikimit të mbrojtjes dhe të operacioneve ushtarake. Për shembull, një raport i informatave ushtarake të zbulimit do të mund të vlerësonte anët e forta, dobësitë dhe vend-ndodhjen e kundërshtarit ushtarak, para nisjes së operacioneve ushtarake.

Vendimi për themelimin e shërbimeve informative varet nga shumë faktorë, duke përfshirë nevojat specifike të qeverisë, kërcënimet potenciale me të cilat ballafaqohet shteti dhe popullata e tij, resurset njerëzore dhe financiare në dispozicion për shërbimet e tilla informative, si dhe vullneti politik për t'u përfshirë në aktivitete të zbulimit. Shumica e vendeve kudo në botë e kanë të themeluar së paku njërin nga katër llojet e shërbimeve informative të përmendura më lart. Në disa vende, një organizatë e vetme mund të luajë rolin e dy ose më shumë shërbimeve informative, por qoftë për arsye ligjore ose për të mbrojtur specializimet dhe mandatet e ndryshme të secilit shërbim, shumica e shteteve demokratike e shmangin themelimin e shërbimeve informative që luajnë më shumë se një rol. Tabela një, më poshtë, tregon disa shembuj të zgjedhur të shërbimeve informative nëpër botë, dhe aty shihet se disa vende kanë vendosur të mos themelojnë shërbime informative në të gjitha (katër) lëmitë.

Vendi	Shërbimet Informative të Vëndit	Shërbimi Informativ i Jashtëm	Shërbimi Informativ Kriminal	Shërbimi Informativ i ushtarak
AUSTRIA	Drejtoria e Përgjithshme për Siguri Publike	X	Shërbimi Informativ Penal (BK)	Shërbimi Informativ Ushtarak (HNA)
KANADAJA	Shërbimi Informativ Kanadez i Sigurisë (SHIKS)	Enti i Sigurisë së Komunikimeve (CSE)	Policia Mbretërore e Kalorësisë Kanadeze (RCMP)	Drejtori i Përgjithshëm i Divizionit Informativ (J2/DG Int)
REBUPLIKA E ÇEKISË	Shërbimi Informativ Çek i Sigurisë (BIS)	Zyra për Marrëdhënie me Jashtë dhe Informata (UZSI)	X	Agjencia Informative Ushtarake e Mbrojtjes
FRANCA	Drejtoria e Sigurisë Territoriale (DST)	Drejtoria e Përgjithshme për Siguri të Jashtme (DGSE)	Drejtoria Qendrore e Policisë Gjyqësore (DCPJ)	Drejtoria e Shërbimit Informativ Ushtarak (DRM)
GREÇIA	Shërbimi Informativ Kombëtar (EYP)	X	X	X
SLLOVENIJA	X	Agjencia Sllovene Informative dhe e Sigurisë (SOVA)	X	Shërbimi Informativ dhe i Sigurisë (VOMO)
MBRETËRIA E BASHKUAR	Shërbimi i Sigurimit (MI5)	Shërbimi Informativ Sekret (SIS)	Agjencia e Krimeve të Organizuara Serioze (SOCA)	Shtabi Informativ i Mbrojtjes (DIS)
SHTET E BASHKUARA TË AMERIKËS	Departamenti i Sigurisë së Brendshme (DHS)	Agjencia Qendrore e Zbulimit (CIA)	Byroja Federale e Hetimeve (FBI)	Agjencia Informative e Mbrojtjes (DIA)

Tabela 1: Disa shembuj të përzgjedhur të shërbimeve informative nëpër botë.

Praktikat më të mira për zhvillimin ose reformimin e shërbimeve informative

Kur një qeveri merr vendim për të themeluar ose reformuar shërbimin informativ, siç ka bërë qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2004, ekzistojnë disa parakushte të caktuara që duhet të merren parasysh, siç është reforma në legjislacion, resurset njerëzore dhe financiare, dispozitat e udhëheqjes dhe të mbikëqyrjes, dinamika e brendshme politike dhe marrëdhëniet me jashtë. Veç kësaj, disa praktika më të mira për reformën dhe zhvillimin e zbulimit janë krijuar dhe sot konsiderohen si udhëzimet e përgjithshme jetike për themelimin ose reformimin e shërbimeve informative në kontekstin demokratik evropian të shekullit 21.

Për shembull, megjithëse nuk mund t'i gjeni dy raste identike, është e mundur të identifikohen standardet ligjore të llogaridhënies demokratike të shërbimeve informative që të shërbejnë si udhëzime të përgjithshme. Në vitin 2005, Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, Komisioni Parlamentar Norvegjez për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Zbulimit dhe Qendra e të Drejtave të Njeriut e Universitetit Durham janë bashkuar në një ekip për të identifikuar dhe rekomanduar standarde për llogaridhënien demokratike në fushën e zbulimit. Kur bëhet themelimi ose reformimi i një organizate të zbulimit, ky raport sugjeron se do të ishte ideale që t'u përmbaheshin këtyre praktikave më të mira:²

- Legjislacioni i ri dhe publik duhet të identifikojë qartë rolin e organizatës së zbulimit, detyrat dhe kufizimet, të caktojë kufirin e kompetencës së saj territoriale, të definojë konceptin e kërcënimit dhe në mënyrë eksplicite të ndalojë hetimin e kundërshtarëve politik vendor ose aktet e ligjshme të avokimit, protestën ose mospajtimin, përveç nëse ato paraqesin një rrezik të qartë ndaj shtetit apo qytetarëve të tij;
- Secila fuqi e veçantë (si përgjimi i telefonit) e dhënë një shërbimi informativ, duhet të definohet me ligj dhe duhet t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, përveç se i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe shqyrtimit adekuat para dhe pas shfrytëzimit të saj;
- Informatat e grumbulluara dhe dosjet e krijuara nga shërbimet informative duhet të rregullohen me ligj që përcakton mekanizmat dhe standardet mbi mbrojtjen e të dhënave, që mundëson bërjen publike të disa informatave jo të ndjeshme dhe definimin e udhëzimeve të përgjithshme për shkëmbimin e informatave të zbulimit me partnerët vendorë ose të huaj;
- Një ministër duhet të bëhet përgjegjës me ligj për formulimin e politikave mbi çështjet e zbulimit dhe për miratimin e çështjeve politike të ndjeshme, ndërsa shërbimit informativ duhet t'i jepet qasja adekuate ndaj ministrit për drejtim dhe mbështetje;
- Ligji duhet t'u lejojë ministrave të aprovojnë, kur është e përshtatshme, bashkëpunimin ndërkombëtar me partnerët e huaj, por duhet të parandalojë çdo aktivitet bashkëpunimi ose shkëmbimi të informatave që do ta minonte ligjin vendor ose të drejtat ndërkombëtare të njeriut;
- Mbrojtësit ligjor duhen parandaluar keqpërdorimin e zbulimit nga ministrat dhe shërbyesit civil dhe duhet të sigurojnë se nuk po ndërmerret asnjë veprim nga organizata e zbulimit për të promovuar interesat e një partie politike ose të një individi të caktuar;

² Këto udhëzime të përgjithshme janë frymëzuar drejtpërdrejt nga disa prej 84 praktikave më të mira të parashtruara në hollësi në Born H dhe Leigh I, Të Bërit e Lëmit të Zbulimit të Përgjegjshëm: Standardet Ligjore dhe Praktikrat më të Mira për Mbikëqyrjen e Angjencive të Zbulimit, (Shtëpia e Shtypit e Parlamentit të Norvegjisë, 2005). [Born H and Leigh I, *Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies*, (Publishing House of the Parliament of Norway, 2005)].

-
- Një organ i specializuar për mbikëqyrje parlamentare, i mandatuar nga ligji, duhet të ngarkohet me monitorimin dhe hetimin e efikasitetit, legalitetit dhe përbalueshmërisë së aktiviteteve të shërbimit informativ, me publikimin e konstatimeve dhe të rekomandimeve; dhe
 - Ankesat dhe pakënaqësitë e qytetarëve duhet të merren, dëgjohen dhe të trajtohen në mënyrë të përshtatshme nga një zyrë e pavarur ose gjykatë në rrjedhën e një procesi transparent, dhe (teorikisht) publik

Krijimi i një shërbimi informativ për Kosovën

Edhe pse vendimi mbi krijimin e një shërbimi informativ për Kosovën do të mund të ishte i ndjeshëm politikisht dhe mbase kundërthënës, një organizatë e tillë do të luante një rol të rëndësishëm duke u siguruar vendim-marrësve të Kosovës këshilla të parashikueshme, me kohë, relevante, të sakta, duke u mundësuar atyre që të marrin vendime, duke qenë të informuar, në dobi të popullatës së Kosovës dhe të fqinjëve të saj. Emisari Special i KB-ve, Martti Ahtisaari, rekomandoi në propozimin e tij zyrtar që Kosova, "...duhet të krijoj një agjenci vendore të sigurimit për monitorimin e kërcënimeve të paraqitura ndaj sigurisë së brendshme të Kosovës", dhe kjo agjenci e re duhet të jetë, "...profesionale, apolitike, shumetnike dhe i duhet nënshtruar mbikëqyrjes parlamentare dhe administrimit civil." Disa organizata dhe mbështetës gjithashtu pëlqejnë këtë ide.

Themelimi i një organizate të tillë do të merrte kohë, sidomos që ajo të bëhet plotësisht operative, efikase dhe e aftë për të dhënë atë lloj të këshillave që u nevojiten vendim-marrësve për të ofruar siguri dhe stabilitet në Kosovë. Prandaj, debati mbi krijimin e Shërbimit të Sigurisë të Kosovës (ShSK) duhet të filloj sa më parë që të jetë e mundur, ashtu që nëse merret në të vërtetë vendimi për të krijuar një organizatë të tillë, njëfarë diskutimi dhe debati i dobishëm do të duhej që tashmë të kishte ndodhur. Ky dokument, krahas një dokumenti përcjellës, *Të Kuptuarit e Shërbimeve Informative*,³ është paramenduar si një kontribut ndaj këtij diskutimi, para një vendimi përfundimtar mbi krijimin e një shërbimi informativ për Kosovën.

Edhe pse ende duhet të merret vendimi përfundimtar mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, diskutimi i krijimit të një shërbimi informativ për Kosovën është i vlefshëm.

Rekomandimet e mëposhtme janë bazuar në parimet demokratike dhe praktikat më të mira ndër-kombëtare, të cilat duhet t'i udhëzojnë vendim-marrësit në procesin e krijimit të Shërbimit të Sigurisë të Kosovës.

Mandati dhe detyrat

Si çdo agjenci tjetër qeveritare, ShSK-ja duhet të vendoset nën mbikëqyrjen e Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, për të qenë efikas ShSK-ja duhet të jetë profesional, apartiak dhe i pavarur nga çdo parti politike. Prandaj, roli i politikanëve duhet të jetë i kufizuar në monitorimin e aktiviteteve në emër të popullit në mënyrë që të sigurohet që nuk përdoret si mjet shtetëror ose i ndonjë partie politike. Në këtë kontekst, dhe me qëllim që të sigurojë drejtim adekuat për ShSK-në dhe të përcaktojë kufirin e fushëveprimit të mandatit të tij, Kuvendi i Kosovës duhet të debatojë, të aprovoj një ligj mbi Shërbimin e Sigurisë së Kosovës. Ky ligj duhet të:

- Që zyrtarisht të themelojë ShSK-në si agjenci të pavarur, të pozicionuar në nivel të njëjtë, por pa attribute të njëjta sikurse ministritë, dhe nën autoritetin e Kryeministrit;
- Të definojë ShSK-në si një shërbim informativ krejtësisht vendor, i cili është përgjegjës për grumbullimin e informatave dhe prodhimin e informatave të zbulimit relevante për sigurinë e Kosovës dhe për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike;
- Të përshkruajë çdo kompetencë të posaçme që i jepet ShSK-së, siç është mbajtja nën përcjellje në vendet jopublike, përgjimi i komunikimeve dhe përcjellja, si masa të jashtëzakonshme që kërkojnë urdhër bastis-

³ Mellon J, *Të Kuptuarit e Shërbimeve Informative*, (Forumi i Iniciativës Qytetare dhe Saferworld, Dhjetor 2006) [Mellon J, Understanding Intelligence Services, (Forum of Civic Initiatives and Saferworld, December 2006)]. Ky dokument i shkurtër themelor definon dhe shpjegon konceptin kryesor që lidhet me shërbimet informative, duke përfshirë mandatin dhe mbikëqyrjen e tyre, në kontekstin bashkëkohor evropian.

jeje të gjykatës para përdorimit të tyre, dhe i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor pas përdorimit të tyre;

- Të kufizojë juridiksionin e ShSK-së në kufijtë zyrtarë të territorit të Kosovës, duke e ndaluar çfarëdo aktiviteti të zbulimit nga ShSK-ja, duke përfshirë përgjimin e komunikimeve, që duhet të ndërmerren jashtë këtyre kufijve;
- Të definojë konceptin e kërcënimit duke e kufizuar kuptimin e tij në ato aktivitete ose individë të cilët mund ta kërcënojnë sigurinë e Kosovës përmes spiunazhit, sabotazhit, dhunës politike, terrorizmit ose aktiviteteve të fshehta të drejtuara nga qeveritë e huaja;
- Që në mënyrë eksplicite të ndalojë ShSK-në nga hetimi i akteve të avokimit të ligjshëm, protestës, mospajtimit, përveç nëse këto akte janë qartazi të lidhura me kërcënimin ndaj sigurisë së Kosovës;
- Që në mënyrë rigoroze të ndalojë çfarëdo veprimi të fshehtë që ka për synim ndikimin në kushtet politike, ushtarake, shoqërore ose ekonomike të një vendi të huaj përmes mjeteve, ndër të tjera, siç janë propaganda, përkrahja e fraksioneve të huaja politike ose ushtarake, ndihma ndaj qeverive të huaja, sabotimi, vrasja ose çrregullimi i aktiviteteve në tokë të huaj;
- Që të përcaktojë elementë mbrojtës për të parandaluar keqpërdorimin e ShSK-së nga individët, partitë politike ose grupet e interesit; dhe
- Që në mënyrë eksplicite të deklarojë se të gjitha veprimet e ShSK-së pa përjashtim duhet të respektojnë dhe të jenë në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokolleve të tyre, si dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Ndër të tjera, Kryeministri i Kosovës duhet që një herë në vit të përgatisë dhe publikojë një dokument ku paraqiten informatat e zbulimit dhe kërkesat e sigurisë. Këto kërkesa duhet të paraqesin një dokument të detyrueshëm për ShSK-në për t'i udhëhequr aktivitetet e tij dhe t'i caktojë objektivat e tij. Çdo shmangie ndaj këtyre kërkesave nga ShSK-ja, duhet të hetohet menjëherë nga Kuvendi i Kosovës, dhe përveç nëse nuk paraqitet justifikim i duhur për shmangien e tillë nga Drejtori i ShSK-së, ShSK-ja duhet të udhëzohet t'i rishikojë aktivitetet dhe objektivat e veta në përputhje me këto kërkesa.

Plotësimi me personel

Për të përmbushur rolin dhe mandatin e tij, ShSK-ja duhet të tubojë personelin më të kualifikuar të mundshëm, por ligji për krijimin e ShSK-së duhet gjithashtu të krijojë disa kërkesa dhe udhëzimet e përgjithshme që lidhen me plotësimin e tij me personel sa më të kualifikuar të mundshëm. Për të siguruar cilësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin e personelit, ShSK-ja duhet që përmes rregullave dhe politikave të brendshme:

- Të caktojë kushtet për moshën dhe arsimin minimal për rekrutimin e personelit të ri;
- Të imponojë një procedurë të rreptë dhe tërësisht korrigjuese për t'u ndërmarrë për cilindo anëtar të ri të personelit me qëllim të vlerësimit të rrezikut që kandidati të mos bëhet kërcënim për ShSK-në, nxjerrjen e informatave të ndjeshme të palët e treta, rrezikimin e personelit tjetër të ShSK-së, me përfshirjen në aktivitete të paligjshme, ose duke e kompromituar namën e ShSK-së;
- Të përcaktojë kushtet për të gjithë personelin e ri që t'i nënshtrohet një trajnimit të gjithanshëm në programet e trajnimit brenda organizatës në fillim të punësimit të tyre;

- Të krijoj një kod të brendshëm të sjelljes për të gjithë stafin, për adresimin e çështjeve si respektimi i ligjit, diskriminimi, ngacmimet, konflikti i interesave dhe marrëdhëniet me publikun, krahas procesit disiplinor eksplicit në rastet e sjelljes së pahijshme ose të paligjshme; dhe
- Të ndaloj stafin që të jenë anëtarë ose të jenë të lidhur me ndonjë organizatë jashtë ShSK-së, në ç'rast ky anëtarësim apo lidhje ka mundësi të dëmtoj punën, namin, respektueshmërinë ose efikasitetin e ShSK-së, personelit të ShSK-së ose të autoriteteve të Kosovës.
- Japë Nën-Komisionit kompetencën për të marrë vendime që janë të detyrueshme nga pikëpamja ligjore, që mund të sigurojnë masa ligjore korigjuese ndaj një ankuesi, i cili ka një rast të justifikueshëm, duke përfshirë edhe dhënien e kompensimit dhe shkatërrimin e materialit të mbajtur nga ShSK-ja;
- Japë Nën-Komisionit autoritetin për të themeluar komisione të hetimit, ad hoc, për të hetuar ankesa të caktuara publike ose incidente ku është e përfshirë ShSK-ja;

Mbikëqyrja parlamentare

Mbikëqyrja parlamentare është mekanizëm me anë të të cilit anëtarët e Kuvendit të Kosovës duhet të debatojnë dhe të mbikëqyrin mandatin, metodat, strukturat dhe buxhetin e ShSK-së dhe të hetojë efikasitetin e saj në përmbushjen e nevojave të Kosovës, si dhe përputhjen e saj me të drejtën nacionale dhe ndërkombëtare dhe standardet e të drejtave të njeriut. Për ta themeluar këtë mekanizëm, Ligji për krijimin e ShSK-së duhet të:

- Bëjë thirrje për krijimin e Nën-Komisionit për Shërbimin e Sigurisë të Kosovës në kuadër të Komisionit për Siguri;
- Definojë mandatin mbikëqyrës të Nën-Komisionit kur bën vlerësimin dhe hetimin e legalitetit, efikasitetit, buxhetit dhe kontabilitetit, përputhshmërisë me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut, dhe aspektet e politikave dhe ato administrative të ShSK-së;
- Ngarkojë me përgjegjësi Nën-Komisionin, të ndara ato me Ombudspersonin e Kosovës, t'i marrë dhe procesojë ankesat nga qytetarët kundër ShSK-së dhe t'i hetojë ankesat e tilla;
- Referohet në rregullat e brendshme të Kuvendit të Kosovës për çështjet që lidhen me korigjimin e gabimeve, emërimin, heqjen dhe zëvendësimin e anëtarëve të Nën-Komisionit, duke theksuar nevojën që anëtarësia të jetë proporcionalisht e përfaqësuar në anëtarësinë e Kuvendit të Kosovës, me një ndalesë për ministrat apo ish-stafin e ShSK-së që të anëtarësohen;
- Japë kompetenca dhe autoritet të mjaftueshëm por të përvijuar mirë që t'i mundësojë Nën-Komisionit inicimin e hetimeve sa i përket aktiviteteve dhe menaxhmentit të brendshëm të ShSK-së, duke përfshirë edhe autoritetin për qasje në disa informacione të klasifikuara, dëshmitarë subpoena (me fletë-hirrje) dhe në marrjen e dëshmimeve nën betim.

Megjithëse roli mbikëqyrës i Nën-Komisionit duhet të përqëndrohet kryesisht në aktivitetet e ShSK-së, ai poashtu duhet të monitoroj buxhetin e ShSK-së që të sigurohet se fondet janë shfrytëzuar sipas planifikimit, dhe se asnjë fond nuk po trans-

ferohet jashtë ShSK-së pa autorizimin e Kuvendin e Kosovës.

Pavarësia dhe paanshmëria

Roli i ShSK-së duhet të jetë të sigurojë këshilla të paanshme dhe të sakta për vendim-marrësit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre politike, prejardhjes, pikëpamjeve politike dhe marrëdhënieve. Prandaj, ShSK-ja duhet të jetë e paanshme, por poashtu e pavarur nga këta vendim-marrës. Ndër të tjera, ajo duhet të mbetet e lirë nga ndërhyrjet e individëve, partive politike ose grupeve të interesit. Këto parime janë thelbësore për zhvillimin e suksesshëm të një shërbimi të sigurisë efikas dhe me llogaridhënie demokratike. Prandaj, ligji për krijimin e ShSK-së duhet të:

- T'ia ndalojë në mënyrë eksplicite çdo individ, partie politike ose grupi të interesit marrjen e asistencës ose informatave nga ShSK-ja për qëllime personale ose partiake;
- T'ia ndalojë në mënyrë eksplicite çdo individ, partie politike ose grupi të interesit ndikimin ose përpjekjen për të ndikuar në shkarkimin e personelit të ShSK-së, me autoritet të tillë mbi personelin që t'i mbetet vetëm Drejtorit të ShSK-së; dhe
- Të kërkojë që pa përjashtim, çdo kërkesë ose udhëzim nga Qeveria e Kosovës ndaj ShSK-së të jetë me shkrim dhe menjëherë t'i publikohet Nën-Komisionit mbi Shërbimin e Sigurisë të Kosovës.

Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet me organizatat e tjera të Kosovës

ShSK-ja duhet të krijojë dhe zhvillojë marrëdhënie

të mira me një numër agjencish dhe organizatash të Kosovës. Megjithëse këto marrëdhënie do të varen kryekëput nga kushtet për informata zbulimi dhe të sigurisë të Kryeministrit dhe nga prioritetet dhe objektivat e ShSK-së, ajo duhet të krijojë lidhje me:

- Këshillin e Sigurisë të Kosovës, (krijimi i të cilit është propozuar nga Propozimi i Qartë për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës), i cili i raporton Kryeministrit dhe i cili ka mandat për zhvillimin e një strategjie të sigurimit për Kosovën;
- Forcën e Sigurisë të Kosovës (e propozuar në mënyrë të ngjashme);
- SHPK-në, me qëllim të marrjes së raporteve mbi situatën ditore dhe për të shkëmbyer me SHPK-në ndonjë informatë zbulimi, e cila mund të jetë relevante për luftën e saj kundër krimit;
- Drejtorinë e SHPK-së për Analiza të Krimeve, me qëllim të marrjes së të gjitha raporteve mbi zbulimin e veprave penale dhe të analizave, dhe për të ndarë çfarëdo informatash zbulimi të cilat do të mund të ishin relevante për përcaktimin e profileve të organizatave kriminale dhe për ndjekjen penale të kriminelëve;
- Policinë Kufitare të SHPK-së, me qëllim të marrjes së statistikave dhe të raporteve që kanë të bëjnë me kalimin e kufijve të Kosovës dhe pas kërkesës të kenë qasje në bazën e saj të të dhënave, dhe t'i sigurojë Policisë Kufitare të SHPK-së ndonjë informatë zbulimi, e cila do të mund t'i parandalonte njerëzit ose mallrat nga hyrja/dalja në/nga Kosova nëse ata/ato paraqesin kërcënime potenciale të sigurisë ose kriminale ndaj Kosovës ose fqinjëve të saj;
- TMK-në, apo ndonjë organizatë pasardhëse, për marrjen e informacioneve mbi emergjencat civile, fatkeqësitë në industri ose katastrofat natyrore, dhe për të ndarë çfarë-

do informatash që do të mund të ishin relevante për përgatitjen e saj për krizat civile dhe menaxhimin e tyre;

- Ministrinë e Punëve të Brendshme, me qëllim të marrjes së informatave dhe të statistikave përkitazi me lëvizjen e njerëzve në Kosovë dhe jashtë saj, rreth regjistrimit qendror civil dhe bazës së të dhënave, dhe të ndajë me të çfarëdo informate, e cila do të mund të ishte relevante për detyrat e saj;
- ZSP-në, me qëllim të marrjes së çfarëdo informatave që kanë të bëjnë me qetësinë publike dhe emergjencat për të cilat është ngarkuar të bëjë koordinimin, grumbullimin dhe përhapjen, dhe të ndajë me të çfarëdo informate zbulimi, e cila do të mund të ishte relevante për rolin e tij të kontrollit të krizave ose që do të duhej të shpërndahej në mbarë institucionet e qeverisë së Kosovës;
- Pesëmbëdhjetë ministritë, me qëllim të marrjes së informatave, statistikave, planit ose politikave që kanë të bëjnë me administratën e Kosovës dhe ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë shëndetësinë, arsimin, telekomunikimet, etj., të ndajë me të çfarëdo informatash që do të mund të ishin relevante për aktivitetet e tyre; dhe
- Këshillat Komunale për Siguri dhe Këshillat Lokale për Siguri Publike, me qëllim të marrjes së çfarëdo informatave që kanë të bëjnë me trendet the problemet e sigurisë së komunitetit në nivelet komunale dhe të komunitetit, të ndajë me ta çfarëdo informatash që do të mund të ishin relevante për përmirësimin e sigurisë së komunitetit në Kosovë.

Secila prej këtyre shkëmbimeve dhe marrëdhënieve duhet të kodifikohet dhe të formalizohet përmes memorandumeve të marrëveshjes me shkrim dhe, nëse është relevante, zyrtarët e ndër-

lidhjes të ShSK-së duhet të dërgohen të punojnë në kuadër të organizatave ose institucioneve të ndryshme partnere.

Ndërlidhja me organizatat e huaja

Disa kërcënime ndaj sigurisë dhe rendit publik të Kosovës mund të zënë fill nga jashtë territorit të saj. Prandaj, do të jetë thelbësore për ShSK-në që të krijojë marrëdhënie efikase me organizatat e huaja me qëllim të parandalimit të kërcënimeve të tilla, duke i materializuar ato me anë të informimit të vendim-marrësve të Kosovës në mënyrë të saktë dhe me kohë. Në të njëjtën kohë, organizatat e huaja mund të përfitojnë nga informatat e zbulimit të përgatitura nga ShSK-ja ose nga njohuritë e ekspertëve të përpunuara nga oficerët e saj, prandaj mund të kërkojnë që të hyjnë në marrëveshje formale me ShSK-në sa i përket shkëmbimit të informatave dhe ekspertizës. Ndër të tjera, këto organizata të huaja mund të jenë në gjendje t'i sigurojnë ShSK-së ndihmesë për themelimin dhe zhvillimin e saj. Prandaj, ShSK-ja duhet të krijojë lidhje formale me organizatat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurinë e që janë të vendosura në Kosovë, duke përfshirë KFOR-in, agjencitë e zbulimit të vendeve të huaja dhe zyrtat diplomatike të vendosura në Kosovë, me qëllim të:

- Marrjes dhe këmbimit të informatave dhe të informatave të zbulimit;
- Kërkimit dhe ofrimit të mbështetjes për hetime të përbashkëta në fushën e zbulimit që kërkojnë përfshirjen e agjencive nga më shumë se një shtet, sidomos për rastet ku hetimi kapërcen juridiksione të shumëfishta;
- Kërkimit të ndihmesës në trajnimin dhe aftësimin e kuadrove (ngritjen e kapaciteteve) të udhëheqjes së ShSK-së, oficerëve, analistëve dhe personelit mbështetës; dhe

- Kërkimit të ndihmës për blerjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, automjeteve dhe të pajisjeve.

Mirëpo, Qeveria e Kosovës dhe ShSK-ja do të duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshme në mbajtjen e pavarësisë së tyre nga organizatat e huaja. Pavarësisht qëllimeve të tyre të mira dhe ndihmesës substanciale, disa organizata të huaja mund të tentojnë të ndikojnë direkt ose indirekt të ushtrojnë ndikim në planet dhe prioritetet e ShSK-së. Meqë ShSK-ja duhet të punojë vetëm për të mirën e qeverisë dhe popullatës së Kosovës, në bashkëpunimin dhe marrëdhënien e saj me organizatat e huaja, duhet ta ruajë pavarësinë dhe përqëndrimin e saj të orientuar ndaj Kosovës gjatë gjithë kohës.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Pas vendimit të pritur gjerësisht për themelimin e ShSK-së, menjëherë duhet të arrihet pajtimi për një hartë praktike dhe realiste të rrugës, ku të nënvizoheshin hapat e nevojshëm për krijimin e ShSK-së dhe të subjekteve të tjera përkatëse, dhe vendosjen e një planifikimi kohor real për krijimin e tij. Objektivi kryesor i kësaj harte të rrugës do të duhej të jetë që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm i ShSK-së dhe aty do të duhet të:

- Bëhet thirrje për një rekrutim fillestar të përfërsisht 60 deri 70 përqind të fuqisë punëtore të gjithmbarshme të pritur, në mënyrë që të mundësohet rritja graduale e fuqisë punëtore në të ardhmen në përputhje me nevojat reale, rrethanat e reja, kufizimet buxhetore ose prioritetet e reja;
- Rekomandojë krijimin e një programi për arsimimin e vazhdueshëm të personelit të ShSK-së, duke përfshirë trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për udhëheqje, oficerë, analistë dhe

personel mbështetës gjatë gjithë periudhës së punësimit të tyre;

- Kërkojë procedura rigorozë dhe të hollësishtme për menaxhimin e buxhetit dhe të shpenzimeve të ShSK-së që nga fillimi, në përputhje me praktikën më të mira ndërkom-bëtare dhe rajonale dhe me objektivin e lehtësimit të rishikimit në të ardhmen; dhe
- Rekomandojë që ShSK-ja të minimizojë investimet e veta në infrastrukturë të re (duke përfshirë automjetet) sa më shumë që të jetë e mundur për t'u përqëndruar në ngritjen e kapaciteteve dhe në prioritetet operative.

Sendërtimi i llogaridhënies publike

Derisa hollësitë teknike dhe legjislative për mënyrën e themelimit të ShSK-së në përputhje me praktikën më të mira dhe parimet demokratike janë jashtëzakonisht të rëndësishme, suksesi i tyre jashtë mase varet nga kapaciteti i popullatës që të kuptojë dhe shpreh pikëpamjet e veta mbi çështjet e zbulimit. Mirëpo, shumë kosovarë ende u referohen përvojave të tyre në 'çështjet e zbulimit' nën regjimet e mëparshme, duke i perceptuar çështjet e zbulimit me një shkallë të lartë të skepticizmit madje edhe të frikës.

Popullata e Kosovës ka nevojë të debatojë për çështjet që lidhen me sigurinë dhe zbulimin po aq lirshëm sa mund të diskutojë për ekonominë, shëndetësinë ose arsimin. Diskutimi i hapur do t'i demistifikonte këto çështje të ndjeshme dhe nganjëherë tabu, duke u dhënë qasje qytetarëve të vendim-marrësit dhe duke e zhvilluar rolin e popullatës si kujdestar mbrojtës dhe avokat për ndryshim.

Drejtëpërdrejt, dhe përmes shoqërisë civile, njerëzit e Kosovës duhet të jenë në gjendje t'i ngrajnë shqetësimet e veta mbi çështje si përgjimi i telefonave, respektimi i intimitetit, ndikimi i dina-

mikave dhe rivaliteteve politike mbi mbikëqyrjen dhe menaxhimin e sektorit të sigurisë, rreziqet e animit të personelit të ShSK-së, angazhimi dhe perceptimet e komuniteteve pakicë. Debate dhe diskutime publike duhen mbajtur sa më shpejt dhe para ndonjë vendimi të rëndësishëm mbi sigurinë dhe zbulimin, në mënyrë që t'u lejohet vendimmarrësve të Kosovës që të marrin parasysh pritjet, shqetësimet dhe perceptimet e popullatës. Përndryshe, vendim-marrësit rrezikojnë ftohjen e popullatës dhe përjetësimin e idesë se zbulimi i preokupon vetëm ata që janë në pushtet dhe mund të menaxhohet prapa dyerve të mbyllura.

Diskutimi i hapur e publik për çështjet e zbulimit mund të promovohet në mënyra të llojlojshme, siç janë anketat publike, diskutimet e fokus gru-

peve, dokumentarët televiziv, fushatat e informimit publik, seminarët ose ligjeratat universitare, seancat e posaqme parlamentare me pjesëmarrje të publikut, artikujt gazetaresk dhe debatet televizive. Prandaj, harta e rrugës për themelimin dhe zhvillimin e ShSK-së si hap fillestar duhet të bëjë thirrje për shumë punë në këtë fushë si kontribut ndaj llogaridhënies publike. Megjithatë, është me rëndësi të madhe që aktivitetet në këtë drejtim të promovojnë debat të sinqertë, që të bëhen përpjekje që të sigurohet përfshirja e të gjitha grupeve, duke përfshirë ato të marginalizuarat, ndërkaq vendim-marrësit dhe publiku të inkurajohen të marrin pjesë dhe të përgjigjen. Nevojitet kjo mënyrë e debatit, sesa thjesht marrëdhënie me publikun dhe edukim, për të siguruar pjesëmarrje të sinqertë dhe kuptimplotë të publikut në procesin e themelimit dhe të rregullimit të ShSK-së.

Në kontekstin evropian të shekullit 21, informata e zbulimit i referohet informatës që është përpunuar dhe analizuar për t'u ndihmuar vendim-marrësve, por për arsye të ndryshme, e që më së shumti lidhen me të kaluarën autoritare të Kosovës, zbulimi është bërë një "fjalë e ndytë" për Kosovarët. Çështja e zbulimit sporadikisht ka dalë në mediat e Kosovës, por pa vëmendjen e vazhdueshme dhe kërkuese. Me daljen në pah të propozimeve të reja për krijimin e një shërbimi informativ vendor për Kosovën, bëhet gjithjë e më e rëndësishme dita e ditës të nxitet një diskutim i hapur dhe i shëndoshë mbi këtë temë si për të informuar politikëbërjen dhe për të inkurajuar përfshirjen e publikut në këto çështje.

Mekanizmat, parimet dhe proceset e rekomanduara në këtë raport, megjithëse sfiduese në shumë aspekte, ofrojnë udhëzime të qarta për ata të cilët do të punojnë në krijimin, drejtimin dhe mbikëqyrjen e këtij shërbimi. Puna e tyre do të përfshijë shumë sfida dhe ata që i ndërmarrin ato do të ballafaqohen me shumë pyetje të vështira, për shembull:

- Si mund të vendosen elemente mbrojtës ligjor efikas për të rregulluar në mënyrë efikase ShSK-në, duke patur parasysh kornizën komplekse ligjore të Kosovës dhe kapacitetet e kufizuara të Kuvendit të Kosovës?

Përfundim

- A do të duhej që të rekrutohen në ShSK apo të përjashtohen, anëtarët e organizatave ekzistuese jozyrtare të zbulimit?
- Si mund të bashkërendohen këshillat dhe mbështetja për ShSK-në nga qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare të interesuara?
- Çfarë hapash mund të ndërmerren për ta mbrojtur shërbimin e ri nga infiltrimi ose ndikimi i palejueshëm, qoftë i natyrës politike, kriminale ose të huaj?
- Si mund të ndërtohet besimi në ShSK në mesin e popullatës, duke përfshirë komunitetet pakicë, të cilat kanë frikë të bazuar nga institucionet e sigurisë?

Pyetjet si këto duhet të jenë thelbësore për çdo debat mbi themelimin e një shërbimi të ri informativ për Kosovën dhe qartë, si parimet e larta dhe konsiderimet praktike do të aplikohen për t'iu përgjigjur këtyre. Se a duhet të çohen mëtej rekomandimet aktuale për krijimin e ShSK-së, do të kërkohen përpjekje të konsiderueshme nga ata që janë të përfshirë në këtë proces për të mbështetur përfshirjen e një game të gjërë të aktorëve në një debat të tillë dhe për sigurimin që politikat dhe praktikat reflektojnë këto vështrime dhe shqetësime.

Për lexim të mëtejshëm

Bearne S et al., *Strukturat Kombëtare Vendimmarrëse të Sigurisë dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë*, RAND Evropë, Qershor 2005 [Bearne S et al., *National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform*, RAND Europe, June 2005]. <<http://tinyurl.com/y46c72>>. Një raport gjithpërfshirës mbi ciklin e informatave të zbulimit, kontrollin dhe dhënien e përgjegjësisë nga shërbimet informative, si dhe legjislacionin mbi çështjet e zbulimit në kontekstin e reformës në sektorin e sigurisë, e bën atë jashtëzakonisht relevant për kontekstin aktual të Kosovës.

Federata e Shkencëtarëve Amerikanë, *Programi i Resurseve në Fushën e Zbulimit [Federation of American Scientists, Intelligence Resource Program]*, <<http://tinyurl.com/3zkx>>. Kjo faqe e internetit ofron një pasqyrë të përgjithshme e të shpejtë të shërbimeve informative nëpër botë.

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, *Shërbimet informative*, Mars 2006 [Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces, *Intelligence Services*, March 2006], <<http://tinyurl.com/umf6n>>. Informata themelore mbi definicionin, kategoritë dhe standardet demokratike e bashkëkohore në fushën zbulimit.

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, *Mbikëqyrja Parlamentare e Shërbimeve Informative*, Mars 2006 [Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces, *Parliamentary Oversight of Intelligence Services*, March 2006]. <<http://tinyurl.com/yys4q4>>. Informata themelore mbi rolin, rëndësinë dhe sfidat e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit.

Hannah G, O'Brien K dhe Rathmell A, *Çështjet e Zbulimit dhe Legjislacioni i Sigurisë për Reformën e Sektorit të Sigurisë*, RAND Evropë 2005 [Hannah G, O'Brien K and Rathmell A, *Intelligence and Security Legislation for Security Sector Reform*, RAND Europe, 2005]. <<http://tinyurl.com/y6vnle>>. Ky raport i RAND-it shqyrton rolin e shërbimeve të zbulimit në reformën e sektorit të sigurisë dhe nënvizon rëndësinë e kontrollit dhe llogaridhënies në strukturat e shërbimeve të zbulimit.

Shulsky A dhe Schmitt G, *Lufta e Heshtur: Të Kuptuarit e Botës së Shërbimeve të Zbulimit*, (Potomac Books, 2002) [Shulsky A and Schmitt G, *Silent Warfare: Understanding the World of Intelligence*, (Potomac Books, 2002)]. <<http://tinyurl.com/vn2og>>. Njëri nga librat më të mirë dhe më në dispozicion mbi teorinë dhe konceptet në fushën e zbulimit.

VENDI SIGURTË
BEZBEDNOMESTO
SAFE PLACE

Duke ndërtuar sigurinë në Kosovë
Izgradimo bezbednost na Kosovu
Building security in Kosovo

Projekti Vend i Sigurtë është program pune i përbashkët i organizatave joqeveritare Saferworld dhe FIQ që mbështetë sektorin e sigurisë në Kosovë për një zhvillim të efektshëm, llogaridhënës dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit.

www.safeplaceproject.org

Saferworld

The Grayston Centre, 28 Charles Square
London N1 6HT, United Kingdom
+44 (0)20-7324-4646
www.saferworld.org.uk

Forumi i Iniciativës Qytetare

Rr. Andrea Gropa, 29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0)38-248-677
www.fiq-fci.org